



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË


- QENDRA e BE-së e KUVENDIT -

LAJME BE

korrik 2014
QBE-nr. 2/2014



PROGRAMI DHE PRIORITETET E KRYESIMIT ITALIAN ME KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Më 1 korrik 2014 Italia e mori kryesimin gjashtëmuor me Këshillin e Bashkimit Evropian. Prioritetet e kryesimit të treshit 18 muor të Italisë, Letonisë dhe Luksemburgut janë stimulimi i rritjes, krijimi i vendeve të punës, stabiliteti financiar i eurozonës dhe përforsimi i rolit global i BE-së. Në seancën plenare të Parlamentit Evropian, më 2 korrik 2014, nga ana e kryeministrit të Italisë, Mateo Renzi u prezantuan prioritetet e kryesimit italian me BE-në.

Nxitja e rritjes ekonomike dhe punësimi, BE-ja si sferë e demokracisë dhe punësimi, BE si sferë e demokracisë, të drejta dhe liri dhe rol më të rëndësishëm në BE në korniza globale, janë tre kriteret kryesore të kryesimit italian me Këshillin e BE-së.

demokracisë dhe sigurinë e Evropës. Në agjendën e kryesimit lartë qëndron përkrahja e stabilitetit, prosperitetit dhe rritjes që qëndrueshme. Kryesimi italian në program deklaroi se do të synojë që t'i inkurajojë vendet kandidatë dhe kandidatët potencial, në përpjekjet të vazhdojnë me zbatimin e reformave të brendshme të nevojshme për harmonizimin me legjislacionin e Unionit. Në program është cekur se BE-ja duhet të demonstrojë kredibilitet dhe përpjekje të qartë për procesin e zgjerimit, me qëllim që t'i motivojë vendet kandidatë dhe kandidatët potencial që t'i marrin hapat e nevojshme për përparim në procesin e aderimit.

Lidhur me Republikën e Maqedonisë, Kryesimi italian do të synojë në inkurajimin e vazhdimin të rrugës së integritetit të shtetit.

Gjatë kryesimit italian do të bëhet zgjedhje e përbërjes së re të Komisionit Evropian, Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë dhe siguri të jashtme dhe Kryetari i Këshillit Evropian.

Faqja zyrtare e internetit e kryesimit italian:
<http://italia2014.eu/en/>

Përmbajtja e lajmeve:

Programi dhe prioritetet e kryesimit italian me Këshillin e BE-së	1
Grupet politike të Parlamentit Evropian	2
Mbledhja konstituive e Parlamentit Evropian	2-4
Fakte për parlamentarët e rinj	4
Parlamenti evropian zgjedh kryetar të ri të Komisionit Evropian.	4-5
Në fokusin e seancës së dytë plenare të Parlamentit Evropian.	5
Programi dhe prioritetet e prezantuara të kryesimit italian me BE-në në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë	6
Ekonomia qarkulluese - Evropa pa hedhurina	7
Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në Horizont 2020	7
Masa për zvogëlimin e papunësisë tek rinia	8
Venecia digjitale 2014	8
Takimi i 11-të i Këshillit për Stabilizim dhe Asociim mes RM-së dhe BE-së	9
Kalendari BE/ shtator 2014	9

Kryesimi italian do të përqendrohet që rritjen ekonomike dhe punësimin t'i vendos në qendër të politikave evropiane, si dhe përforsimin e ekonomisë evropiane dhe monetare, përkrahje të investimeve në sektorët kyç dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, infrastrukturën dhe shërbimet digjitale. Kryesimi përpjekjet do t'i koncentrojë në masat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe përmirësimin e qasjes në kredi përmes politikës më të gjerë për zhvillim të inovacioneve në sektorin industrial evropian. Përmes krijimit të sinergjisë pozitive me Ekspo Milano 2015, temë qendrore e cila është "Ushqimi për planetin dhe energjia për jetë", kryesimi do të fokusohet edhe në çështjet nga sfera e zhvillimit të qëndrueshëm. Me rëndësi të madhe është sigurimi i funksionimit të mirë dhe bashkëpunimi me institucioneve të BE-së. Theksi i kryesimit do të vendoset në përforsimin e BE-së në sferën e lirisë, siguri dhe drejtësi, krijimin e politikës së përbashkët për azil dhe migrim dhe përforsimin e rolit të BE-së në korniza globale.

Politika e zgjerimit është prioritet strategjik dhe mjet themelor për promovimin e paqes,

GRUPET POLITIKE NË PARLAMENTIN EVROPIAN









Anëtarët e Parlamentit Evropian organizohen në grupe politike në bazë të përkatësisë politike, e jo në bazë të nacionalitetit të tyre. Për formimin e grupit politik janë të nevojshëm më së paku 25 anëtarë të PE dhe me më së paku $\frac{1}{4}$ e vendeve anëtare të BE-së të përfaqësohen në grup.

Anëtarë të caktuar nuk i takojnë asnjë grupit politik—deputetë të pavarur në BE.

Në Parlamentin Evropian për momentin janë formuar 7 grupe politike.

<http://www.results-elections2014.eu/en/election-results-2014.html>

01.07.2014

	Grupi i Partive Popullore Evropiane (ERR)	29.43%	221 mandate
	Grupi i Aleancës Progressive të Socialistëve dhe Demokratëve në PE (S&D)	25.43%	191 mandate
	Konservativët dhe Reformuesit Evropian (ECR)	9.32%	70 mandate
	Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropë (ALDE)	8.92%	67 mandate
	E majta e Bashkuar Evropiane/ E majta e gjelbër Nordiste (GUE/NGL)	6.92%	52 mandate
	Të gjelbrit/ Aleanca e Lirë Evropiane	6.66%	50 mandate
	Grupi - Evropa e Lirisë dhe Demokracia e Drejtpërdrejtë (EFDD)	6.39%	48 mandate
	независни пратеници кои не припаѓаат на ниту една политичка група (NI)	6.92%	52 mandate

SEANCA KONSTITUIVE E PARLAMENTIT EVROPIAN



Në mbledhjen konstituive të Parlamentit Evropian e cila u mbajt më 1 korrik 2014, morën pjesë 751 deputetë, me të cilën u shënuar fillimi i mandatit të tetë parlamentar nga zgjedhjet e para të drejtpërdrejta në vitin 1979.

Në agjendën e seancës plenare ishte zgjedhja e kryetarit të Parlamentit Evropian, nënkryetarë dhe kuestorë, debati për samitin e BE-së i mbajtur më 27 qershor të këtij viti, si dhe prioritetet e kryesimit italian me Këshillin e BE-së në gjashtë muajt e ardhshëm.

Me 409 vota nga 612 votave të vlefshme, për kryetar të Parlamentit Evropian në 2 , 5

vitet e ardhshme eurodeputetët përsëri e zgjedhën Martin Shulc.

Eurodeputetët zgjedhën 14 nënkryetarë të Parlamentit Evropian dhe 5 kuestorë. U soll vendim për përbërjen e 20 komiteteve parlamentare të cilët luajnë rol të rëndësishëm në formimin e legjislacionit, si dhe për përbërjen e 2 nën komiteteve të PE.

Çdo komitet zgjedh kryetar dhe deri 4 nënkryetar, me mandat prej 2,5 vjetësh.

" Ky Parlament është zemra e demokracisë në nivelin e BE-së. Parlamenti Evropian çdo herë do të jetë në anën e popullit, do të punojë në përmirësimin e jetës së përditshme të qindra milionë evropianëve. Parlamenti Evropian do të punojë në mënyrë të dinjitetshme dhe të drejtë të respektimit dhe mos diskriminimit. Në emër të këtij parlamenti, unë do të punojë me energji edhe më të madhe, transparencë dhe dukje në gjithë atë që e bëjë për Evropën".

Martin Shulc, Kryetar i Parlamentit evropian

Karrierën politike Martin Shulc e filloi në moshën 19 vjeçare si anëtar i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë. Në moshën

31 vjeçare u zgjodh Kryetar i Rajnës Veriore Vestfalisë, në funksion qëndroi 11 vjet. Shulc ka përvojë afatgjate si eurodeputet, anëtar edhe i Parlamentit Evropian që nga 1994 dhe ka marrë pjesë në punën e një numri të madh të komiteteve dhe nën komiteteve. Në vitin 2004 Shulc është zgjedhur lideri i grupit të socialdemokratëve të PE-së. Shulc është luftëtar i të drejtave sociale, për promovimin e rritjes dhe vendeve të punës, reformimin e tregjeve financiare, luftën kundër ndryshimeve klimatike, përpiqet për barazi dhe krijimin e Evropës më të fuqishme dhe më demokratike. Martin Shulc më 17 janar 2012 e mori mandatin me 387 vota me mandat prej 2.5 vjet.



<http://www.europarl.europa.eu/the-president/en/>

Numri i anëtarëve të 20 komiteteve dhe 2 nën komiteteve të Parlamentit Evropian

AFET	Komiteti i Çështjeve të Jashtme	71
DEVE	Komiteti për Zhvillim	28
INTA	Komiteti për Tregti Ndërkombëtare	41
BUDG	Komiteti për Buxhete	41
CONT	Komiteti për Kontroll Buxhetor	30
ECON	Komiteti për Çështje Ekonomike dhe Monetare	61
EMPL	Komiteti për Punësim dhe Çështje Sociale	55
ENVI	Komiteti për Mjedis Jetësor, Shëndet Publik dhe Siguri të Ushqimit	69
ITRE	Komiteti për Industri, Hulumtim dhe Energjetikë	67
IMCO	Komiteti për Treg të Brendshëm dhe Mbrojtje të Konsumatorëve	40
TRAN	Komiteti për Transport dhe Turizëm	49
REGI	Komiteti për Zhvillim Rajonal	43
AGRI	Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	45
PECH	Komiteti për Peshkatori	25
CULT	Komiteti për Kulturë dhe Arsime	31
JURI	Komiteti për Çështje Juridike	25
LIBE	Komiteti për Liritë e Qytetarit, Drejtësi dhe Punë të Brendshme	60
AFCO	Komiteti për Çështje Kushtetuese	25
FEMM	Komiteti për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore	35
PETI	Komiteti për Ankesa	35
DROI	Nën komiteti për të Drejtat e Njeriut	30
SEDE	Nën komiteti për Siguri dhe Mbrojtje	30

"... Kur Evropa do të bënte "selfie" sot , fotografia do të ishte e lodhshme dhe e dorëhequr. Liderët Evropian duhet të jenë këmbëngulës dhe vendimmarrës se si do ta mbanin pozicionin në Evropë si udhëheqës të çështjeve globale.... Tani kur kemi stabilitet... Na nevojitet rritje si element themelor të politikës Evropiane..."

- pjesë e bisedës së Kryetari të Qeverisë së Italisë, Matteo Renzi, në debatin e seancës plenare të PE-së me rastin e marrjes së kryesimit italian me Këshillin e BE-së.
02.02.2014



ec.europa.eu

FAKTE PËR EUROPALAMENTARËT E RINJ



Kryetari i ri i Komisionit Evropian, funksionin do ta

Anëtari më i moshuar në përbërjen aktuale në Parlamentin Evropian ka 92 vjet dhe është anëtar grek i grupit politik të së Majtës së Bashkuar Evropiane/ e majta e gjelbër nordeze / derisa eurodeputeti më i ri i cili vjen nga Danimarka ka 26 vjet dhe është anëtar i grupit të Konservativëve dhe Reformistëve Evropian. .

Rreth 2/3 (66.67%) nga eurodeputetët nga Malta janë gra derisa përqindja më e vogël e grave deputete janë nga Lituania (9.09%). Rreth 70% e eurodeputetëve gjermanë janë rizgjedhur në zgjedhje.

PARLAMENTI EUROPIAN ZGJEDH KRYETAR TË RI TË KOMISIONIT EUROPIAN



<http://www.europarl.europa.eu/news>

Këshilli Evropian në takimin e 27 qershorit të këtij viti për kandidat për kryetar të Komisionit Evropian e propozoi Zhan Klod Junker, ish kryeministër i Luksemburgut, i cili vjen nga radhët e Partisë Popullore Evropiane, e cila në zgjedhja ka fituar më së shumti vende në Parlamentin Evropian.

Më 8 dhe 9 korrik të këtij viti, Zhan Klod Junker i prezantoi planet e tij para grupeve politike në PE, me qëllim të sigurimit të përkrahjes para votimit në seancën plenare të PE. Shumica e nevojshme e votave për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit Evropian arrin më së paku 376 nga gjithsej 751 eurodeputetë.

Më 15 qershor 2014, në seancën plenare eurodeputetët e zgjodhën Zhan—Klod Junker, për kryetar të ri të Komisionit Evropian. Përkrahje për kandidaturën e tij dhanë 442 prej 729 eurodeputetëve të cilët votuan. Kundër kandidaturës u prononcuan 250 eurodeputetë, 47 ishin të përmbajtur, ndërsa 10 vota ishin të pavlefshme.

marrë më 1 nëntor të këtij viti, me mandat prej 5 vjetësh. Në tetor të këtij viti eurodeputetët do të duhet të prononcohen për përbërjen e plotë të Komisionit Evropian.

Në fjalimin para eurodeputetëve, Junker tha se në tre muajt e parë të mandatit të tij do të prezantojë paketë për vendet e punës, rritje dhe investime, për 300 miliardë euro plotësuese për tre vitet e ardhshme, për projekte të cilat do të fokusohen në energjetikë, infrastrukturë dhe në sferën digjitale.

Lidhur me përbërjen e Komisionit të ri Evropian, do të vendoset edhe komisar përgjegjës për kartën e të drejtave fundamentale të BE-së, si dhe do të investohet përpjekje për sigurimin e barazisë gjinore në pushtetin ekzekutiv të Unionit.

Kryetari i ardhshëm i Komisionit Evropian ka informuar për qëllimin e tij që të sigurojë se energjia nuk do të shfrytëzohet si vegël politike dhe se varësia energjetike e disa vendeve anëtare do të zvogëlohet.

Lidhur me politikën e migrimit, Junker do ta mbrojë parimin e lëvizjes së lirë të punëtorëve në kuadër të BE-së dhe do ta përforcojë bashkëpunimin me vendet e treta duke promovuar politikë të re evropiane të migrimit legal.

Lidhur me zgjerimin, Junker deklaroi se në 5 vitet e ardhshme nuk pritet të ketë vende të reja t'i bashkohen BE-së, por negociatat aderuesve që janë në rrjedhë do të

vazhdojnë.

Gjatë fushatës evropiane për zgjedhjet e PE, Zhan Klod Junker ka prezantuar 5 prioritete kryesore, plani i tyre kyç për migrim dhe qëllimet e politikës së jashtme, në 3 dokumente të arritshme në më shumë gjuhë evropiane. (<http://juncker.epp.eu/my-priorities>)

NË FOKUSIN E SEANCËS SË DYTË PLENARE TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Komisioni Evropian kohë më parë publikoi se planifikon tërheqjen e propozim-direktivës për pushim të lindjes, nga shkaqet që edhe pas 4 viteve disa vende anëtare e bllokojnë çështjen në Këshill.

Në seancës e dytë plenare të Parlamentit Evropian, më 15 korrik të këtij viti, eurodeputetët kanë kërkuar që Këshilli i BE-së t'i vazhdojë bisedat në Parlamentin për propozim direktivën për pushim të lindjes. Qëllimi i direktivës së propozuar është përforcimi i të drejtave të grave në BE përmes sigurimit të pushimit të plotë të lindjes me pagesë dhe mbrojtja e tyre gjatë kthimit në vendin e punës. Parlamenti Evropian për draft direktivën në lexim të parë ka votuar që në tetor të vitit 2010, me zgjerimin e pushimit të lindjes prej 14 në më së paku 20 javë si dhe garancia për marrjen e rrogës së plotë gjatë mungesës.

Parlamenti Evropian në seancën e 16 korrikut 2014 me 421 votë "për", 170 "kundër" dhe 32 "të përmbajtur", i miratoi nominimet e 4 komisarëve të Komisionit Evropian, të cilët do t'i marrin masat e atyre komisarëve të cilët ishin të zgjedhur për eurodeputetë. Komisarët e rinj funksionin do ta kryejnë së bashku me përbërjen aktuale të Komisionit mandati i të cilëve pritet deri më 31 tetor të këtij viti. Jurki Kadainen nga Finlanda do ta zëvendësojë Oli Renin dhe do të jetë përgjegjës për çështjet ekonomike dhe monetare si dhe për euron, Ferdando Neli Feroçi nga Italia do ta zëvendësojë Antonio Tejanin dhe do të jetë përgjegjës për industrinë

dhe sipërmarrësin, Martine Reisherts nga Luksemburgu do ta zëvendësojë Vivian Reding dhe do të jetë përgjegjëse për të drejtat dhe të drejtat fundamentale dhe Jacek Dominik nga Poloniado ta zëvendësojë Janush Levandovski dhe do të jetë përgjegjës për programim financiar dhe buxhet. Pritet së shpejti që këshilli ta vërtetojë vendimin e Parlamentit Evropian.

Eurodeputetët kërkuar transparencë më të madhe në negociatat për lirinë transatlantike mes SHBA-së dhe BE-së.

U dha përkrahje për aderimin e Lituanisë në eurozonë nga janari i vitit të ardhshëm.


Eurodeputetët në seancë kanë debatuar për ngjarjet në Irak dhe Ukrainë, ndërsa votuan edhe për përbërjen e 44 delegacioneve interparlamentare.



4 komisarët e rinj të Komisionit Evropian

«Parlamenti evropian dha përkrahje për hyrjen e Lituanisë në eurozonë, nga 1 janari 2015 »

PROGRAMI DHE PRIORITETET E PREZANTUARA TË KRYESIMIT ITALIAN ME BE- në NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Evropa –fillim i ri është motoja e Kryesimit italian



www.sobranie.mk

Në mbledhjen e parë të Komisionit për Çështje Evropiane në përbërjen aktuale parlamentare, e mbajtur më 7 korrik 2014 nga ana e ambasadorit të Republikës së Italisë në Republikën e Maqedonisë, Ernesto Masimino Belevi, u prezantuan Programi dhe prioriteti për punën e kryesimit italian me Këshillin e BE-së për periudhën 1 korrik –31 dhjetor 2014. Në seancë u ftuan dhe morën pjesë edhe nëtarët e Këshillit Nacional për Eurointegritim, Komisioni për Politikë të Jashtme dhe Komiteti i Përzier parlamentar RM-BE, zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i obliguar për Çështje Evropiane, z. Fatmir Besimi, shefi i delegacionit të BE-së në Republikën e Maqedonisë, Aivo Orav dhe ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së në Republikën e Maqedonisë, Aivo Orav dhe ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së në Republikën e Maqedonisë. Prioritetet e kryesimit të trefishtë me BE-në, Italia, Letonia dhe Luksemburgu, janë të fokusuar në stimulimin e rritjes, krijimit të vendeve të punës, stabilitetit financiar në eurozonë dhe për forcimin e rolit global të BE-së.

Motoja e kryesimit italian është “Evropa, fillim i ri”, e cila do të realizohet përmes tre shtyllave: nxitja e rritjes ekonomike dhe



www.sobranie.mk

"... Dua ta theksojë dëshirën time se në muajt e ardhshëm, realizimi i agjendës evropiane do të jetë gjithashtu gjithëpërfshirëse dhe dinamike, pse edhe jo më shumë sesa ishte deri tani... Ne kemi parasysh se Republika e Maqedonisë ka filluar procesin e dialogut të nivelit të lartë ku reforma e gjyqësorit është njëra nga shtyllat kryesore... duhet të punojmë më shumë". Ermira Mehmeti, kryetare e Komisionit për Çështje Evropiane.

punësimi, BE-ja si rajon i demokracisë, të drejta dhe liri, dhe roli i BE-së në korniza globale. Lidhur me politikën e zgjerimit të BE-së, Kryesimi italian do të synojë që t'i inkurajojë vendet candidate dhe kandidatët potencial në përpjekjet për zbatimin reformave.

Në mbledhjen e Komisionit me diskutime morën pjesë: Ermira Mehmeti kryetare e Komisionit për Çështje Evropiane, Antonio Milloshoski nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme, Ilija Dimovski nënkryetari i Këshillit Nacional për Eurointegritim, Kenan Hasipi bashkëkryetar i Komitetit të Përzier Parlamentar RM-BE, deputetët: Aleksandar Nikollovski, Artan Grubi, Nolla Ismajlovska, Bekim Fazliu dhe anëtarë i Këshillit Nacional për eurointegritim prof. Dimitar Mirçev.

"...Çdo here kur flasim për vlerat bazike prej të cilave nuk ka lëshime siç është demokracia, liria e Evropës në një kuptim metaforik, porosia jonë deri në kryesimin e ardhshëm por edhe deri tek të gjitha institucionet e BE-së është se problemet mund të zgjidhen vetëm me më shumë Evropë në Union.... Qytetarët e Republikës së Maqedonisë procesin e zgjerimit, e shohin si shans për zhvillim më të mire dhe më të shpejtë ekonomik, vendosja e shkallës plotësuese të sigurisë së Republikës së Maqedonisë, si në zgjerimin e demokracisë dhe kapaciteteve në vet shtetin dhe mundësi ose ndjenjë për besim të ndërsjellë që Maqedonia dhe BE-ja duhet ta kenë"

Ilija Dimovski, nënkryetar i Këshillit Nacional për Eurointegritim

Tejkalimi drejt ekonomisë qarkulluese është në agjendën e efikasitetit të resurseve në kuadër të strategjisë Evropa 2020, për rritje të

Ekonomia qarkulluese - Evropa pa hedhurina

matur, të qëndrueshme dhe përfshirëse. Në vend të vendimeve të drejtuara drejt afatit përfundimtar të përdorimit të produkteve, në ekonominë qarkulluese hedhurinat eliminoohen me dizajnin, ndërsa inovacionet janë të pranishme në zinxhirin e plotë të vlerës së produkteve. Për tejkalim në ekonominë qarkulluese, janë të nevojshme ndryshimet e dizajnit të produktit, modele të reja të punës dhe të tregut, mënyra të reja të shndërrimit të hedhurinave në resurse dhe mënyra të reja të sjelljes së konsumatorëve. Ekonomia qarkulluese paraqet shfrytëzim të përsëritshëm, korrigjim, ripërtërije dhe riciklim të materialeve ekzistuese dhe produkteve. Kjo nënkupton ndryshim të plotë të sistemit të inovacioneve, jo vetëm në teknologji por edhe në organizimin, shoqërinë, metodat e financimit dhe politikat.

Komisioni Evropian më 2 korrik të këtij viti miratoi komunikatën me të cilën propozon programin për ekonomi qarkulluese dhe Evropë pa hedhurina. Me tejkalimin në ekonominë qarkulluese në BE, pritet rritja e riciklimit, të krijohen vende të reja të punës, rritje ekonomike dhe zvogëlim të emisioneve të gazrave të qelqit dhe ndikimi i tyre mbi mjedisin jetësor. Deri në vitin 2030 propozohet riciklimi i 70% të hedhurinave komunale dhe 80% nga hedhurinat e paketimit. Përmes seleksionimit të hedhurinave aty për aty, dhe metodologjia përkatëse për njësimin e shkallës së riciklimit, do të sigurohet kualitet i lartë në riciklim dhe do të kontribuohet në zhvillimin e tregut të lëndëve të para sekondare kualitative. Me përdorim afatgjatë produktiv të materialeve, ripërdorimi i tyre dhe efikasitet të përmirësuar, pritet që të përmirësohet konkurrenca e BE-së në skenën globale. Kjo qasje e re e nxjerrë në komunikimin e KE-së, e sqaron mënyrën me cilën inovacionet në tregjet për riciklimin e materialeve, modelet e reja të biznesit dhe dizajni ekologjik, do të kontribuojnë për të ashtuqajturën ekonomia e zero-hedhurina.


Në industri sot njihet potenciali i fuqishëm për krijimin e vlerës ekonomike përmes përmirësimit të produktivitetit të resurseve. Vlerësimet e BE-së janë se me pengimin e krijimit të hedhurinave, dizajni ekologjik, përdorimi i përsëritshëm i

hedhurinave dhe përdorimi më i mirë i resurseve, industria evropiane do të kishte realizuar kursim prej rreth 600 miliardë euro, ndërsa emisionet vjetore të gazrave të qelqit do të ishin zvogëluar për 2-4%.

Propozime ligjvënëse të Komisionit Evropian kanë të bëjnë me Direktivën kornizë për hedhurina, Direktiva për vendin e hedhurinave, Direktiva për paketim dhe për hedhurina, dhe të njëjtat janë me qëllim që të krijohet kornizë juridike e cila do të ndihmojë që ekonomia qarkulluese të bëhet realitet. Legjislacioni do të jetë më i thjeshtë dhe do të përforcohet bashkëpunimi me Komisionit dhe vendeve anëtare me qëllim që të sigurohet zbatim më i mirë.

Propozimet e Komisionit priten të marrin përkrahje të Këshillit dhe të Parlamentit Evropian. Përparimi në realizimin e qëllimeve për produktivitet të resurseve do të vijojë përmes semestrit ekonomik evropian. Korniza politike për promovimin e ekonomisë qarkulluese në mënyrë plotësuese do të zhvillohet gjatë viteve të ardhshme.

<http://ec.europa.eu/environment/circular-economy/>
http://ec.europa.eu/environment/waste/target_review.htm



«Nevojiten ndryshime të dizajnit të produkteve, modele të reja të punës dhe të tregut, mënyra të reja për shndërrimin e hedhurinave në resurse dhe mënyra të reja të sjelljes së konsumatorëve»

Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në Horizont 2020

Më 1 korrik të këtij viti, në Bruksel u nënshkruan marrëveshje mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë, Serbisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Moldavisë, me të cilën vendet siguruan qasje në Horizontin 2020—program i ri kornizë shtatëvjeçar i BE-së për hulumtim të inovacioneve. Marrëveshjet asociuese do të zbatohen në mënyrë retroaktive, nga 1 janari i këtij viti dhe do t'i mundësojnë subjekteve nga gjashtë vendet t'i shfrytëzojnë mundësitë për financimin projektit në kuadër të programit Horizont 2020. Me asociimin e gjashtë

vendeve që ndodhë njëkohësisht, pritet rritja e bashkëpunimit rajonal, ndërsa nga vendet pritet që ta ngritin përvojën e deritanishme nga pjesëmarrja në Programin e shtatë kornizë dhe t'i përforcojnë kapacitetet nacionale për hulumtime dhe inovacione.

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/home.html>



<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en>

MASA PËR ZVOGËLIMIN E PAPUNËSISË TEK RINIA



Sipas vlerësimeve të Bashkimit Evropian, rreth 5,2 milionë të rinj nga 28 vende anëtare janë të papunë, që paraqet shkallë të papunësisë prej 22,2% ose 23,3% në eurozonë. Rreth 7,5 milionë të rinj të moshës prej 15-24 vjet janë të papunë, nuk arsimohen përkatësisht nuk trajnohen. Dallimi i shkallës së papunësisë tek rinia mes vendeve anëtare është shumë e madhe. Gjermania ka shkallën më të ulët të papunësisë së rinisë prej 7,8 % derisa në Greqi papunësia është më e madhe me 57,7%, pastaj Spanja 54%, Kroacia 48,7%, Italia 43%, Qiproja 37,3% dhe Portugalia 34,8%.


Në prill 2013 Këshilli i BE-së ka miratuar rekomandime për themelimin e Garancisë për rininë (Youth Guarantee) dhe i bën thirrje vendeve anëtare të sigurojnë se të gjithë të rinjtë nën moshën 25 vjeçare do të marrin oferta kualitative për punë, arsim të vazhdueshëm, trajnim dhe praktikum, në afat prej 4 muajve pas përfundimit të shkollimit. Finlanda ka model më të suksesshëm në ballafaqimin me papunësinë e të rinjve, në vitin 2011 rreth 83,5% e rinisë të cilët kanë kërkuar punë, kanë marrë ofertë në afat prej 3 muajve pas regjistrimit të tyre si të papunë.

Garancia e të rinjve paraqet koncept të ri, njëra nga strukturat më të rëndësishme dhe më urgjente të cilat vendet anëtare duhet 'i zbatojnë që ta zgjidhin papunësinë e lartë

tek rinia, përmes përforcimit të shërbimeve publike për punësim, reforma në arsim dhe sistemet për trajnim, përmirësimin e kualitetit të ofertave në buxhetet nacionale, vendet anëtare duhet të japin prioritete për punësimin e të rinjve, me qëllim që të në ardhmen të shmangen harxhime më të mëdha. Për momentin, vendet anëtare zhvillojnë plane nacionale për zbatimin e Garancisë për të rinjtë. Për përkrahjen e garancisë për rininë dhe për masat për ballafaqim me papunësinë e rinjve, përmes Fondin Solidar Evropian sigurohen më shumë se 10 miliardë euro në nivel vjetor për periudhën 2014-2020. Zbatimi i skemave nacionale të garancisë për të rinjtë përcillet në kuadër të semestrit evropian.

http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-14-466_en.htm
<http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=1036>

ДИГИТАЛНА ВЕНЕЦИЈА 2014



<http://www.digitalvenice.eu/>

Kryesimi italian me Këshillin e BE-së, me përkrahjen e Komisionit Evropian, prej 07-12 korrik të këtij viti, ka organizuar javën e "Venecisë Digjitale 2014", me të cilën u shënuar rëndësia e inovacioneve digjitale për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Në kuadër të ngjarjes u mbajt takim i nivelit të lartë, me pjesëmarrjen e kryeministrit të Italisë dhe kryetarit të Këshillit të BE-së, Matteo Renzi, ë nënkryetari i Komisionit Evropian Neli Kros, politikanë të shquar nga vendet anëtare si dhe përfaqësues të kompanive udhëheqëse digjitale ndërkombëtare. Në mënyrë plotësuese u organizuan 5 punëtori me pjesëmarrjen e ekspertëve, novatorëve, përfaqësuesve qeveritar dhe hulumtuesve, të përkushtuar në të ardhmen e politikave evropiane nga sfera e Agjendës digjitale të BE-së 2020.

Në deklaratën e përbashkët të nënshkruar nga drejtorët ekzekutivë të gjashtë operatorëve udhëheqës evropian të telekomunikacionit, bëhet thirrje në krijimin e politikës së re evropiane për teknologji informatike teknologjike, përmes përkrahjes së zhvillimit të infrastrukturës bashkëkohore digjitale, më të thjeshtë dhe kornizë rregullatorë, sigurimi i qytetërimit digjital, nxitja e krijimit të vendeve të punës dhe ballafaqimi me sfidat globale të internetit.

<http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/news/digital-venice-2014>

TAKIMI I 11-TË I KËSHILLIT PËR STABILIZIM DHE ASOCIM MES REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN

Më 23 korrik 2014 në Bruksel u mbajt takimi i 11-të i Këshillit për Stabilizim dhe Asocim me Republikën së Maqedonisë dhe BE-së, i kryesuar nga senatori Benento Dela Vedova, nënkretar i punëve të jashtme i Republikës Italiane. Komisioni Evropian u prezantua nga euro komisar i zgjerim z. Shtefan Fyle. Delegacioni i Republikës së Maqedonisë udhëhoq nga ministri i Punëve të Jashtme z. Nikolla Poposki, mori pjesë edhe zëvendëskryetari i Qeverisë i obliguar për Çështje Evropiane z. Fatmir Besimi. Këshilli e mori parasysh qëllim primar të vendit, fillimin e negociatave për aderim në BE, duke e konfirmuar përkushtimin e tij të fuqishëm për këtë qëllim dhe duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian. Këshilli i shqyrtoi ngjarjet kyçe nga periudha e kaluar të cilat kanë të bëjnë me plotësimin e kriterëve politike, si dhe me gjendjen lidhur me kriteret ekonomike, bashkëpunimi financiar dhe zbatimin i KSA. Lidhur me kriteret politike, Këshilli u informua për ngjarjet e rëndësishme politike, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare dhe periudhën pas zgjedhjeve. BE-ja i bëri thirrje qeveritarëve nacional që t'i zbatojnë vërejtjet e ODIHR-it me qëllim të përmirësimit të procesit zgjedhor. Këshilli e ka vërejtur formimin e qeverisë së re, si dhe qëllimet e Qeverisë të bashkëpunojë me opozitën dhe të vazhdojë t'i përmirësojë kriteret politike, Këshilli e theksoi nevojën e dialogut konstruktiv përmes spektrit politik. Lidhur me sundimin e të drejtës, Këshilli rikujtoi se niveli i lartë i harmonizimit, duke e përfshirë edhe efikasitetin e përmirësuar të gjykatave, por theksoi se është e nevojshme t'i vihet theks i veçantë pavarësisht dhe kualitetit të drejtësisë. Këshilli e përshëndeti edhe përparimin e arritur në udhëheqjen e evidencës për korrupsionin dhe krimin e organizuar, por e theksoi nevojën për përmirësimin e politikave dhe zbatimin më efikas të ligjeve me qëllim që të arrihen rezultatet konkrete. Këshilli e theksoi nevojën e përfundimit të pasqyrimin për zbatimin e

Marrëveshjes Kornizë të Ohrit sa është e mundur më shpejtë, që të mundet ky proces të përfundojë me rekomandime për politikën. BE-ja shprehu brengosje për marrëdhëniet ndëretnike dhe bëri thirrje për më shumë masa proaktive, afatgjate për ndërtimin e besimit afatgjatë. Këshilli e inkurajoi përpjekjen për pavarësi të administratës dhe respektim të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë. Këshilli për Stabilizim dhe Asocim konfirmoi se vitin e kaluar ekonomia ka filluar të rimëkëmbet, se është mbajtur stabiliteti makro-financiar dhe se inflacioni ka mbetur në korniza të matura. Këshilli e ka përshëndetur marrëveshjen me Qeverinë për prioritetet e ardhshme të dokumentit strategjik për vendin 2014-2020 sipas Instrumentit për ndihmë aderuese. Këshilli e përshëndeti edhe përkushtimin e Republikës së Maqedonisë që të investojë më shumë përpjekje për rritjen e dukshme të shfrytëzimit të fondeve të BE-së dhe përmirësimin e kapacitetit të institucioneve të nevojshëm për zbatimin e tyre. Këshilli për Stabilizim dhe Asocim rikujtoi propozimin e KE-së të tetorit 2009, për tejkalim në fazën e dytë të KSA-së.

<http://www.mfa.gov.mk/?q=node/3566#sthash.QaorE94B.dpuf>



Kalendari BE/ shtator 2014

- 1.Sesioni plenar i Parlamentit Evropian, 15-18 shtator 2014, Strasburg;
- 2.Takim i ministrave të punëve të jashtme dhe çështje evropiane - Këshilli për Punë të Përgjithshme - (General Affairs Council), 29 shtator 2014;
- 3.Forumi Financiar Eurofi 2014, 10-12 shtator 2014, Milano.

<http://europa.eu/newsroom/calendar/>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË

BE qendra e Kuvendit

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup 1000

telefoni: +389 2 3 11 22 55, lokali414 dhe 289

faksi: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

zyre 019

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 u realizua IPA Projekti për “Ndihmë teknike për Parlamentin”, qëllimi i përgjithshëm ishte përforcimi i kapacitetit institucional i Kuvendit dhe me këtë përmirësimi i transparencës së tij dhe përgjegjësi para qytetarëve.

Në kuadër të IPA projektit, u siguria ndihmë financiare dhe profesionale për themelimin e Qendrës së BE-së në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE- Qendrës është që deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe shërbimit të Kuvendit t'i sigurohet qasje më e mirë në informatat lidhur me çështjet e BE-së.

www.sobranie.mk
